



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.53/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Laziç dhe Adnan Konushevci anëtarë, me zyrtarin ligjor, Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR dega në Prizren, për shkak të vendosjes së banerëve në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe koalicionit LDK-AKR dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1600 (njëmijë e gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi një fotografi e printuar nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 04.06.2017, në rrugën kryesore të qytetit për gjatë lumit në Prizren, monitoruesi ynë ka hasur në poster të kandidatit për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR të ngjitura në drunjë të qytetit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se koalicioni PDK-AAK-NISMA ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur posterat e kandidatit për deputet në hapësira publike.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidtët.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni LDK-AKR i datës 06.06.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke e arsyetuar se pas pranimit të ankesës i kemi urdhëruar kandidatët që të ndërmarrin veprime përmirësuese. Më tutje ka theksuar, pasi që është evituar shkelja e pretenduar, ka kërkuar nga PZAP-i që të mos shqiptoj gjorbë, pasi që efekti i ankesës është arritur me vet faktin se janë larguar posterët e kandidatëve.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur dy fotografi nga vendi ku është larguar posteri.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit LDK-AKR është i vendosur në pemë, pra në hapsirë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruar shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga koalicioni në fjalë, është vendosur në pemë pra në rrugë publike, Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë i datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:


- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në pemë. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, e morri parasysh faktin se koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndër marrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.53/2017 më datën 06.06.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.